



**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
(BASHKËFINANCIMI)**

Në mes të

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 451/25 Dt. 25.07.2025

Swisscontact, e përfaqësuar nga Majlinda Rizvanolli Bajraktari, Menaxhere e Projektit "Matching Skills to Jobs"
MSJ, Prishtinë (në tekstin e mëtejmë, MSJ)

dhe

Komunës së Prizrenit, e përfaqësuar nga Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit (në tekstin e mëtejmë:
Komuna)

dhe

Makerspace Innovation Center Prizren - MICP, e përfaqësuar nga Enis Qafëleshi, Drejtor Ekzekutiv (në tekstin e
mëtejmë, MICP)

Neni 1

QËLLIMI I MEMORANDUMIT DHE PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Bazuar në Neni 3, Pika 4 dhe Neni 14, Pika 1.4 të rregullores Komunale nr 001-011-201, dt: 03.01.2024, për kushtet,
kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve,

Bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe MICP-së e ndërlidhur për
bashkëpunim në agjendën digitale të Prizrenit, zhvillimin ekonomik, zhvillimin e bizneseve të reja dhe ekzistuese,
implementimin dhe funksionalizimin e qendrës së Inovacionit, Ndërmarrësisë dhe Trajnimeve të komunës së
Prizrenit dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale rinore të regjionit të Prizrenit ne fushën e teknologjisë
informative.

*MSJ, Komuna e Prizrenit dhe MICP lidhin këtë memorandum bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me qëllim të
zhvillimit të aftësive të avancuara dhe përmirësimit të punësueshmërisë përmes zbatimit të programit të
specializuar të trajnimit në fushën e Shkencave të të Dhënavë (Data Science), nga i cili do të përfitojnë bizneset
(nga e gjithë Kosova), studentët dhe individët profesionist. Ky program synon të përgatisë një fuqi punëtore
konkurruese, të aftë për të adresuar nevojat në rritje të tregut të punës në sektorët me potencial të lartë zhvillimi,
duke ndihmuar në ngritjen e ekonomisë në Kosovë.*

Programi do të implementohet nga MICP në partneritet me institucionin amerikan CNM Ingenuity, në bazë të një
marrëveshjeje licencimi që garanton standarde të larta ndërkombëtare të mësimdhënies. Kjo iniciativë përfshin
gjithashtu bashkëpunim me sektorin privat dhe zgjerim rajonal përmes nën-licencimit të ofruesve të tjerë trajnimi
duke kontribuar në ndërtimin e një ekosistemi të qëndrueshëm të zhvillimit të aftësive në teknologji dhe
inovacion.

**Swisscontact, nëpërmjet projektit MSJ, të financuar nga qeveria Zvicerane, fokusohet në dy komponenta
kryesore: (1) Përmiresimi i kapacitetve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) për të ofruar arsim cilësor dhe
relevant me tregun, në partneritet me sektorin privat; dhe (2) Rritja e produktivitetit të fuqisë punëtore përmes**

MR

SH-Ts

ES¹

ofrimit të programeve të avancuara të trajnimit relevante për industritë në Kosovë. Për të arritur këto rezultate përmes komponentës 2, projekti MSJ do të fokusohet në intervenime që synojnë të adresojnë pengesat kyçë, përfshirë mospërputhjen ndërmjet aftësive të fuqisë punëtore dhe nevojave të tregut të punës, bashkëpunimin e kufizuar ndërmjet bizneseve dhe ofruesve të trajnimeve, mungesën e të dhënavë të besueshme dhe të përditësuara rregullisht për tregun e punës, sfidat strukturore në kulturën e bizneseve familjare, si dhe mungesën e programeve të strukturuara të mentorimit.

Komuna e Prizrenit synon që të inkurajojë punësimin e të rinjëve, nxitjen e ndërmarrësisë dhe nxitjen e zhvillimit të sektorëve të ndryshëm në Komunën e Prizrenit, prandaj Komuna e Prizrenit ka ndarë fonde për vitin 2025, për realizimin e projekteve zhvillimore në përkrahje të sektorit privat me fokus tek të rinjët.

Makerspace Innovation Center – Prizren (MICP) është një organizatë jo-qeveritare me seli në Prizren, e cila angazhohet në fushën e arsimit profesional, programeve të trajnimit në fushën e punësimit, si dhe ofron mbështetje për ndërmarrës të ri dhe biznese startup. MICP është një qendër inovacioni e themeluar në vitin 2017 që synon të zhvillojë dhe promovojë një ekosistem digital duke ndërlidhur shkencën dhe edukimin me industrinë dhe sektorin e biznesit, kryesisht të fokusuar në krijimin e vendeve të punës në ICT.

Neni 2 PËRGJEGJËSITË E PALËVE

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, secila prej palëve zotohet t'i zbatojë përgjegjësitë e mëposhtme, me qëllim të realizimit sa më të mirë dhe efikas të qëllimit të këtij bashkëpunimi.

2.1. Swisscontact përmes projektit MSJ, do të:

- 2.1.1. Bashkëfinancojë aktivitetet e listuara dhe përshkruara në këtë marrëveshje dhe shtojcat e saj, të implementuara nga MICP, në shumën prej **50,000.00 EUR (pesëdhjetë mijë euro)** përmes projektit MSJ.
- 2.1.2. Koordinojë aktivitetet e implementuara nga MICP të përshkruara brenda kësaj marrëveshjeje, në bashkërendim me Komunën e Prizrenit.
- 2.1.3. Monitorojë implementimin e aktiviteteve nga MICP për të siguruar arritjen e qëllimeve të parapara me këtë marrëveshje. Treguesit kryesorë të monitorimit dhe matjes së rezultateve të këtij bashkëpunimi do të specifikohen në Aneksin 3 të kësaj marrëveshjeje.¹
- 2.1.4. Angazhohet aktivisht për mbarëvajtjen dhe realizimin e aktiviteteve të parapara në këtë marrëveshje, përfshirë kontrollin e kualitetit, si dhe pjesëmarrjen aktive apo në rolin e observuesit në aktivitete specifike si p.sh. përzgjedhjen e bizneseve përfituese.
- 2.1.5. Miratojë raportet mujore të dërguara nga MICP, rreth progresit në implementim.
- 2.1.6. Procedojë pagesat tek MICP sipas termave të pagesës, pas miratimit të raporteve respektive sipas planit të pagesave të paraqitura në tabelarin e mëposhtëm të kësaj marrëveshjeje.

2.2. Komuna e Prizrenit do të:

- 2.2.1. Bashkëfinancojë aktivitetet e listuara dhe përshkruara në këtë marrëveshje dhe shtojcat e saj, më së largu deri më 30/10/2025. Bashkëfinancimi bëhet përmes projektit MSJ. Komuna e Prizrenit do të transferojë mjetet në vlerë të **98,100.00 EUR (nëntëdhjetë e tetë mijë e një qind euro)** në llogarinë e mëposhtme:

Bank name: ProCredit Bank Kosovo J.S.C

Account name: Swisscontact Swiss Foundation for Technical Cooperation

Account number: 1110118206060154

- 2.2.2. Koordinojë aktivitetet e implementuara nga MICP të përshkruara brenda kësaj marrëveshjeje, në bashkërendim me projektin MSJ.

¹ Projekti MSJ zbaton një qasje të monitorimit të rregullt përgjatë dhe pas përfundimit të aktiviteteve të marrëveshjes - në kohëzgjatje prej 2 vitesh.

2.2.3. Angazhohet aktivisht për mbarëvajtjen dhe realizimin e aktiviteteve të parapara në këtë marrëveshje.

2.3. **Makerspace - Innovation Center Prizren do të:**

- 2.3.1. Zhvillojë dhe implementojë programin e avancuar të trajnimit në Data Science përmes licencës së siguruar nga partneri ndërkombeart CNM Ingenuity (SHBA), duke ndjekur standardet ndërkombeartare të trajnimit dhe përmbajtjes së kursit.
- 2.3.2. Sigurojë trajnimin e trajnerëve (ToT) të së paku 5 trajnerëve në përputhje me kërkesat e programit Deep Dive të CNM Ingenuity, për të ruajtur cilësinë dhe standardet ndërkombeartare të mësimdhënies.
- 2.3.3. Realizojë dy formate të veçanta të trajnimit: (1) Programi i plotë 12-javor për Data Science dhe (2) Programi 8-javor i pjesshëm për bizneset, për të përfshirë nevoja të ndryshme të grup-moshave dhe profesionistëve.
- 2.3.4. Trajnojë së paku 15 pjesëmarrës në Data Science Bootcamp në vitin e parë të zbatimit, me synimin për një shkallë punësimi prej të paktën 80% të tyre pas përfundimit të programit. Përparësi për marrjen e trajnimit gjatë Data Science Bootcamp do të kenë gratë dhe komunititet jo-shumicë të Kosovës.
- 2.3.5. Bashkëpunojë me deri në 15 kompani në Kosovë për të ju ofruar trajnimin e Data Science për menaxhmentin e mesëm dhe të lartë të kompanive, apo personave të dedikuar për këtë funksion brenda kompanive. Në total, si pjesë e kësaj mbështetjeje, trajnimin për Data Science do t'a marrin deri në 30 persona brenda kompanive të ndryshme në Kosovë.
- 2.3.6. Inicojë partneritete dhe marrëveshje partneriteti (nënlicense) me ofrues të tjera të trajnimeve në Kosovë (p.sh. në Prishtinë dhe Vushtrri), me qëllim të zgjerimit të ndikimit të programit, ruajtjes së cilësisë dhe sigurimit të qëndrueshmërisë së këtij programi.
- 2.3.7. Për bizneset pjesëmarrëse nga komuna të tjera (nëse ka të tilla), MICP do të dorëzojë pranë MSJ-së dëshmitë përkatëse të pagesës për pjesën që nuk mbulohet nga komuna e Prizrenit, si parakusht për disbursimin e kontributit të MSJ-së në bashkëinvestim.
- 2.3.8. Ofrojë mbështetje teknike për pjesëmarrësit gjatë programit, përfshirë mentorim, burime mësimore dhe asistencë praktike në zbatimin e koncepteve, përmes projekteve reale.
- 2.3.9. Zhvillojë dhe zbatojë planin e marketingut dhe fushatat e informimit për të siguruar rekrutim të pjesëmarrësve dhe përfshirjes së grave dhe komuniteteve jo-shumicë në Kosovë.
- 2.3.10. Monitorojë vazhdimit efektivitetin e programit përmes vlerësimeve para, gjatë dhe pas trajnimit, dhe të përgadisë raporte mujore si dhe raportin final në përfundim të këtij aktiviteti. Të gjitha pyetësoret dhe vlerësimet duhet te bëhen në bashkëpunim të ngushtë me MSJ.
- 2.3.11. Bashkëpunojë ngushtë me MSJ dhe Komunën e Prizrenit për realizimin e aktiviteteve në këtë marrëveshje. MICP do të inkadrojë në mënyrë proaktive ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e implementimit të aktiviteteve.
- 2.3.12. Ndërmarrë promovimin dhe informimin në lidhje me aktivitetet e kësaj marrëveshjeje, duke përcjellë praktikat dhe standardet e komunikimit të palëve nënshkruese, dhe duke njojur kontributin e donatorëve: Qeverisë Zvicerane dhe Komunës së Prizrenit respektivisht.
- 2.3.13. Të gjitha palët nënshkruuese të kësaj marrëveshje zotohen të ndjekin praktikat e mira, duke siguruar një proces transparent dhe të drejtë në të gjitha fazat e aktiviteteve.
- 2.3.14. Ndarja e përgjegjësive buxhetore dhe termave të pagesave në mes palëve: Kosotja totale e aktiviteteve të kësaj marrëveshjeje është 183,100.00 Euro. MSJ do të alokojë 50,000.00 Euro, Komuna e Prizrenit do të alokojë 98,100.00 Euro dhe MICP do të kontribuojë me vlerë shërbimesh (in-kind) 35,000.00 Euro për zbatimin e aktiviteteve të listuara përgjatë këtij memorandumi. Buxheti i detajuar për implementimin e këtij aktiviteti është bashkëngjitur në Aneksin I të kësaj marrëveshjeje.

MR

SH-T.

ED

**Neni 3
AKTIVITETET E PROJEKTIT**

1. Të gjitha aktivitetet e projektit synojnë zbatimin e programit të avancuar të trajnimit në fushën e Data Science, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore, përmirësimin e punësueshmërisë, dhe krijimin e një urë lidhëse mes aftësive dhe kërkesave të tregut të punës në Kosovë. Lista e detajuar e programit dhe aktiviteteve që do të implementohen në kuadër të kësaj marrëveshjeje janë të bashkëngjitua në Aneksin I. Programi do të implementohen nga Makerspace – Innovation Center Prizren (MICP), në partneritet me Komunën e Prizrenit dhe projektin MSJ – Swisscontact, dhe në bashkëpunim me institucionin amerikan CNM Ingenuity, përmes një marrëveshjeje licencimi.

**Neni 4
KOORDINIMI DHE KONSULTIMET**

1. Palët pajtohen që gjatë implementimit të kësaj marrëveshje do të shkëmbejnë informacione dhe do të takohen rregullisht (sipas nevojës) për të vlerësuar ndikimin e mbështetjes nga MSJ dhe dinamikat e implementimit të marrëveshjes.
2. Çdo mosmarrëveshje që ka të bëjë me administrimin dhe implementimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit do të zgjidhet nëpërmjet konsultave të palëve në fjalë.

**Neni 5
PROVIZIONET E PËRGJITHSHME**

1. Amandamentimi apo shkëputja e marrëveshjes: Palët kanë të drejtë të shkëpusin pjesëmarrjen në marrëveshje duke dërguar paralajmërim me shkrim 30 ditë më herët.
2. Në rast të nevojës për ndryshim apo përditësim të kësaj marrëveshjeje, përfshirë rishikimin, zgjerimin apo përmirësimin e aktiviteteve me qëllim të përmirësimit të implementimit, palët pajtohen që këto ndryshime do të formalizohen përmes anekseve dhe amendamenteve të bashkangjitura në këtë marrëveshje. Çdo ndryshim i tillë do të jetë i vlefshëm vetëm pasi të jetë nënshkruar nga të gjitha palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje.
3. Data e Hyrjes në fuqi dhe kohëzgjatja: Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të trija palët me kohëzgjatje deri 31/10/2026 dhe e njejta mund të vazhdohet me pëlqimin e palëve deri në realizimin e qëlimeve të projektit.
4. Përfaqësimi: Palët do të përfaqësohen nga personat e mandatuar nga nënshkruesit e marrëveshjes. Personi Kontaktues nga Komuna e Prizrenit është z. Shaqir Totaj - Kryetar, dhe personi kontaktues nga MICP është z. Arbër Kryeziu.

NR

SH-Ts

Neni 6
PËLQIMI I PALËVE

1. Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të marrëveshjes.
2. Mospajtimet ose interpretimet eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshje, do të rregullohen në mënyrë miqësore, me marrëveshje konsensuale.
3. Palët pajtohen që gjatë periudhës së kësaj marrëveshjeje dhe pas përfundimit të saj, nuk do t'i zbulojnë informacionet e ndjeshme, të përfituar gjatë bashkëpunimit pa miratimin e shkruar të palës tjeter. Ky detyrim i konfidentialitetit përfshin, por nuk kufizohet në informacionin teknik, financiar, operacional, dhe të dhënat personale të palëve të përfshira në këtë marrëveshje.

Neni 7
NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI

7.1 - Ky memorandum është nënshkruar më 25 / 07 / 2025 në Prizren.

Palët nënshkruese:

Swisscontact - MSJ

znj. Majlinda Rizvanolli Bajraktari
Menaxhere e Projektit MSJ


Swisscontact


Komuna e Prizrenit

z. Shaqir Totaj
Kryetar



Makerspace Innovation Center Prizren

z. Enis Qafëleshi
Drejtëor Ekzekutiv


**Makerspace
Innovation Center
Prizren**

SHT

Aneks 1: Tabela financiare e projektit dhe financimi i palëve

Programet/Aktivitetet	Koha e implementimit	Kontributet e palëve
Licencimi i programit	Korrik 2025 - Tetor 2025	MSJ: 35,000.00 Euro Komuna: 10,000.00 Euro
<i>Programi 1:</i> Pagese vjetore per perditesimin e kurrikules dhe asistencies teknike per vitin e pare	Korrik 2025 - Tetor 2025	Komuna: 15,500.00 Euro
<i>Programi 2:</i> Strategjia e brendit, marketingut, dhe implementimi i kampanjave promovuese	Korrik 2025 - Tetor 2025	Komuna: 9,500.00 Euro MICP: 2,500.00 Euro
Programi 3: Organizimi i grupit te pare te trajnimeve me 10 biznese	Janar 2026	MSJ: 4,900.00 Euro Komuna: 2,100.00 Euro MICP: 1,500.00 Euro
<i>Programi 4:</i> Organizimi i grupit te dyte te trajnimeve me 10 biznese	Shkurt 2026 - Maj 2026	MSJ: 3,350.00 Euro Komuna: 3,650.00 Euro MICP: 1,500.00 Euro
<i>Programi 5:</i> Organizimi i grupit te trete te trajnimeve me 10 biznese	Maj 2026 - Gusht 2026	MSJ: 2,450.00 Euro Komuna: 4,450.00 Euro MICP: 1,500.00 Euro
<i>Programi 6:</i> Trajnim per studentet (Data science bootcamp) - 20 student nga komuna e Prizrenit	Janar 2026 - Prill 2026	Komuna: 24,000.00 Euro MICP: 3,000.00 Euro
<i>Programi 7:</i> Zgjerimi i ofrimit te programit te trajnimeve ne nivel te regionit te Kosoves	Tetor 2025 - Prill 2026	Komuna: 4,000.00 Euro MICP: 15,000.00 Euro
<i>Programi 8:</i> Organizimi i ngjarjeve te rrjetezimit dhe ceremonive te diplomimit	Shkurt 2026 - Korrik 2026	Komuna: 1,100.00 Euro MICP: 2,000.00 Euro
Programi 9: Paketa e mbeshtetjes per punesim dhe karrierë, pas trajnimit	Prill 2026 - Korrik 2026	Komuna: 5,500.00 Euro MICP: 2,500.00 Euro
<i>Programi 10:</i> Mentorim per studentet & bizneset pjesmarrese pas perfundimit te trajnimit	Janar - Gusht 2026	MSJ: 4,300.00 Euro Komuna: 10,700.00 Euro MICP: 2,000.00 Euro
<i>Programi 11:</i> Dizajnimi dhe zhvillimi i platformes per "Virtual Badge" per konfirmim elektronik te certifikimit	Nentor 2025 - Shkurt 2026	Komuna: 4,000.00 Euro MICP: 1,500.00 Euro
<i>Programi 12:</i> Sistemi i mesimit LMS i formatit online per perfituesit	Korrik 2025 - Tetor 2025	Komuna: 4,000.00 Euro MICP: 2,000.00 Euro

Aneks 2: Orari i pagesave për implementim MSJ – MICP

Pagesat për aktivitete	Koha e pagesës	Shuma për pagesë	Të arriturat
Pagesa 1 - Për fillimin e implementimit të projektit dhe blerjes së licensës	Gusht 2025	89,900.00 €	Pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe fillimit të aktiviteteve sipas planit
Pagesa e dytë – gjatë implementimit të aktiviteteve	Dhjetor 2025	33,000.00 €	Pas realizimit të trajnimit të trajnerëve, organizimit te thirrjes së parë dhe fillimit të trajnimit për grupin e parë të perfituesve
Pagesa e tretë – gjatë implementimit të aktiviteteve	Mars 2026	15,000.00 €	Pas realizimit të trajnimit për grupin e dytë dhe mentorimit të grupit të parë
Pagesa e fundit – pas implementimit të aktiviteteve	Tetor 2026	10,200.00 €	Pas perfundimit të aktiviteteve të projektit dhe pranimit të raportit perfundimtar mbi të arriturat

St. 76

MPC

EQ

Aneks 3: Treguesit për Monitorim dhe Matje të Rezultateve

Treguesi	Përkufizimi	Si matet?	Kush e mat?	Frekuencë
Numri i personave të trajnuar	Numri i pjesëmarrësve që përfundojnë trajnimin. Të zbërthyer në pjesëmarrësit në trajnimin e plotë dhe ata në të pjeshtëm	Lista e pjesëmarrjes dhe certifikimit	MICP	Për çdo grup
Përqindja të punësuar brenda 3 muajve	Përqindja e pjesëmarrësve të punësuar në fushë relevante pas trajnimit	Anketa pas trajnimit	MICP dhe MSJ	3 muaj pas trajnimit
Numri i bizneseve të përfshira	Numri i bizneseve që marrin pjesë ose kontribuojnë në trajnim	Marrëveshje bashkëpunimi / lista e partnerëve	MICP	Vazhdimesht
Kënaqshmëria e bizneseve me shkathtësitë e të trajnuarve	Përqindja e bizneseve që raportojnë përmirësim në shkathtësitë e stafit të trajnuar	Anketë e shkurtër për punëdhënës	MSJ	3 muaj pas çco trajnimi
Numri i trajnerëve të certifikuar	Numri i trajnerëve vendor të certifikuar përmes ToT nga CNM	Raporte të ToT / certifikata	MICP	Vjetor
Përqindja e pjesëmarrësve me shkathtësi të përmirësuara	Pjesëmarrës që raportojnë përmirësim në njohuri dhe vetëbesim	Anketa para dhe pas trajnimit	MICP	Për çdo grup
Numri i fushatave informuese	Numri i fushatave për informim dhe promovim të përfshirjes -me fokus të veçantë te grupet e nënpërfaqësuara	Raporte të aktiviteteve	MICP	Për çdo cikël

MR

St. T.